

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 380/4 Prot.

Tiranë, më 27/04/2022

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë.

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TIRANË
Adresa : Rruga Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz-Tiranë

Për dëgjim : **BORDIT TË ADMINISTRIMIT**
UNIVERSITETIT BUJQËSOR TIRANË


Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", pikës 7.2 të kapitullit VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Metodologjisë së Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, dhe në vijim të procesit të vlerësimit të veprimtarisë audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në Universitetin Bujqësor Tiranë, bashkëlidhur Ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së bashku me planin e veprimit.

Duke shpresuar se rekomandimet e adresuara do t'i shërbejnë rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese, ju kujtojmë se Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve i plotësuar, duhet t'i përcillet DH/AB jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eros Angjeli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr 380/4 Prot.

Tiranë, më 27/04/2022

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar i Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë.

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TIRANË

Adresa : Rruga Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz-Tiranë

Për dijeni :

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TIRANË

Në zbatim të nenit 24, të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pikës 7.2 të kapitullit VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, Metodologjisë së Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë, dhe në vijim të procesit të vlerësimit të veprimtarisë audituese të Njësisë së Auditimit të Brendshëm, në Universitetin Bujqësor Tiranë, bashkëlidhur Ju dërgojmë Raportin Përfundimtar të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së bashku me planin e veprimit.

Duke shpresuar se rekomandimet e adresuara do t’i shërbejnë rritjes së cilësisë së veprimtarisë audituese, ju kujtojmë se Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve i plotësuar, duhet t’i përcillet DH/AB jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HARMONIZIMIT TË KONTROLLIT
TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT PËRFUNDIMTAR
I
VLERËSIMIT TË JASHTËM TË CILËSISË
SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM,
UNIVERSITETI BUJQËSOR TIRANË



PRILL 2022

I.PARATHËNIE	4
II.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
III.HYRJA	8
IV.GJETJET DHE KONKLUZIONET	10
□ STANDARD 1000 - QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA	11
□ STANDARD 1100 – PAVARËSIA DHE OBJEKTIVITETI	14
□ STANDARD 1200 - AFTËSITË DHE KUJDESI I DUHUR PROFESIONAL	18
□ STANDARD 1300 – SIGURIMI I CILËSISË DHE PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT	21
□ STANDARD 2000 - MENAXHIMI I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSSHËM	23
□ STANDARD 2100 - NATYRA E PUNËS	31
□ STANDARD 2200 - PLANIFIKIMI I ANGAZHIMIT	34
□ STANDARD 2300 - KRYERJA E ANGAZHIMIT	38
□ STANDARD 2400 - KOMUNIKIMI I REZULTATEVE	40
□ STANDARD 2500 - MONITORIMI I PROGRESIT	43
□ STANDARD 2600 - KOMUNIKIMI I PRANIMIT TË RISKUT	45
V. REKOMANDIMET E PROPOZUARA	46
VI.OPINION I PËRGJITHSHËM	47
ANEKS 1.....	49
Metodologjia e Përdorur & Burimet e Informacionit	49
ANEKS 2.....	50
Tabelat shoqëruese të Raport vlerësimit.....	50

FALENDERIME

Falenderojmë për bashkëpunimin dhe korrektësinë në komunikim, stafin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm të përfshirë në këtë vlerësim, Administratorin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (ish Administratori i UBT), me të cilët janë zhvilluar intervistat.

Grupi i Vlerësimit

I.PARATHËNIE

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë (UBT) është parashikuar në planin vjetor të Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm.

Ky vlerësim u bazua në nenin 24 të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.22, datë 06.03.2017.

Falenderojmë për bashkëpunimin dhe korrektësinë në komunikim, stafin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm të përfshirë në këtë vlerësim, Administratorin e Fakultetit të Bujqësisë dhe Mjedisit (ish Administratori i UBT), me të cilët janë zhvilluar intervistat

II.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Subjekti i vlerësimit të jashtëm të cilësisë është veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm (SAB), pjesë e strukturës organizative të Universitetit Bujqësor Tiranë.

Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është institucion publik i arsimit të lartë, i llojit universitet, me status të personit juridik public, që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese profesionale dhe të transferimit të dijeve të tretët; ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve dhe shkencës, inovacionit dhe të profesioneve. Ky universitet mbështet veprimtarinë e tij në ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ka në përbërje të tij pesë (5) Fakultete. UBT është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.548, datë 28.07.1951, si Institut i Lartë Bujqësor dhe ka funksionuar si i tillë deri në vitin 1991, ku me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.166, datë 28.05.1991 është bërë emërtimi nga Instituti i Lartë Bujqësor në Universitet Bujqësor i Tiranës.

Organi kolegjal më i lartë akademik, i institucionit të arsimit të lartë, përgjegjës për përmbushjen e misionit të UBT-së është Senati, autoriteti më i lartë drejtues akademik është Rektori dhe organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij është Bordi i Administrimit.

Vlerësim i jashtëm i cilësisë së SAB në UBT, bazohet në nenin 24, të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", në Kapitullin VII të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, në “Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.22, datë 06.03.2017.

Objektivat e vendosura nga grupi lidhur me këtë vlerësim të jashtëm cilësie janë:

- Monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm, përputhshmëria me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm, standardet ndërkombëtare të pranura,
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektet e audituara, dhe;
- Përcaktimi i fushave që kërkojnë ndërhyrje për përmirësim.

Sektori i Auditimit të Brendshëm, subjekt i këtij vlerësimi të jashtëm të cilësisë, është pjesë integrale e strukturës organizative të Universitetit Bujqësor Tiranë (UBT), i cili në Statutin e tij (miratuar me Vendimet e Senatit Akademik nr.5, datë 04.02.2021 dhe nr.17, datë 21.04.2021 dhe Urdhrit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.279, datë 28.07.2021 “Për miratimin e Statutit të UBT” dhe dokumentin “Programi Buxhetor Afatmesëm 2020-2022”, të miratuar me Vendim nr.59, datë 22.07.2019, të Senatit Akademik të UBT), ka përcaktuar misionin dhe vizionin e tij në funksion të qëllimit të UBT.

UBT, ushtron funksionet akademike dhe administrative nëpërmjet Administratës së UBT-së dhe pesë Njësi kryesore që përbëjnë UBT, të cilat sipas nenit 11 të Statutit të UBT janë : Fakulteti

i Bujqësisë dhe i Mjedisit (FBM), Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit (FBU), Fakulteti i Shkencave Pyjore (FSHP) dhe Fakulteti i Mjeksisë Veterinare (FMV), të cilat veprojnë si njësi ekonomiko-financiare të pavarura.

Universiteti Bujqësor i Tiranë në funksion të plotësimit të misionit të tij, të krijimit, transmetimit, zhvillimit e mbrojtjes së dijeve nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si dhe formimit të specialistëve të lartë dhe përgatitjes së shkencëtarëve të rinj në fushën e bujqësisë, ekonomisë dhe zhvillimit rural, mjedisit dhe shkencave të natyrës, mjeksisë veterinarë, inxhinierisë pyjore, bioteknologjisë bujqësore dhe resurseve gjenetike, ka përcaktuar objektiva strategjik konkretë të materializuara në programin buxhetor afatmesëm 2020-2022 (miratuar me Vendim Senati nr.59, datë 22.07.2019 “Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 të UBT”), që mbështet:

1.Rritjen e cilësisë së programeve të studimit mbi bazën e kriterëve të standardeve ndërkombëtare,

2.Përmirësimin e laboratorëve shkencorë dhe zgjerimin e tyre, që nënkupton kompletimin e tyre me pajisje e mjete laboratorike, përmirësimin sa më të mirë të auditorëve të mësimit jo vetëm me pajisje laboratorike, por edhe me mjete të tjera didaktike.

3.Aftësimi praktik i studentëve, përmirësimi e zhvillimi i praktikës profesionale.

4.Rritja e nivelit të kërkimit shkencor në UBT.

5.Rritja e numrit të projekteve Kërkimore-Shkencore.

6.Shtimi i numrit të shërbimeve që Universiteti duhet tju ofrojë palëve të treta.

Vizioni : UBT synon të bëhet qendra më ekselente, më e madhe e edukimit universitar, pasuniversitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, të ushqimit, të mjedisit, administrimit të territorit dhe mbarështrimit të pyjeve.

Spektori i Auditimit të Brendshëm, për periudhën objekt vlerësimi, bazuar në universin e auditimit dhe analizimin e strukturës së UBT, e cila ka në përbërje të tij (neni 5 i Statutit):

- njësi kryesore , që janë fakulteti dhe institute i kërkimit dhe zhvillimit;
- njësitë bazë, që janë departamenti dhe qendra e kërkimit;
- degët, që mund të jenë njësi kryesore ose njësi bazë;
- njësitë ndihmëse, janë strukturat mbështetëse, të cilat ndihmojnë institucionin, njësitë kryesore dhe njësitë bazë në realizimin e veprimtarisë mesimdhënëse, kërkimore-shkencore dhe atë administrative si dhe Ferma Didaktike Eksperimentale (FDE),

në Planin strategjik (2020-2022 dhe 2021-2023) ka identifikuar dhe rishikuar sistemet kryesore, në të cilat do të fokusohet veprimtaria audituese, të cilat përfaqësojnë: sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit; sistemin e krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore; sistemin e pagesave, në të cilin përfshihen edhe shpenzimet për bursat e studentëve; sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar, etj.

GJETJET DHE KONKLuzionET

Në vlerësimin e jashtëm të cilësisë së Spektorit të Auditimit të Brendshëm në UBT, grupi i vlerësimit konstatoi se në veprimtarinë audituese janë respektuar plotësisht kërkesat e kuadrit

rregullator në fuqi, duke konstatuar që disa kritere/fusha kërkonin përmirësim në të ardhmen, të cilat janë të trajtuara në këtë material.

Ndër gjetjet më kryesore përmendim:

- Karta e Auditimit të Brendshëm nuk është përditësuar, pas ndryshimeve të Manualit të AB (miratuar me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë)
- Rregullorja e funksionimit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk parashikon linjën e komunikimit dhe të raportimit të drejtëpërdrejtë tek Bordi i Administrimit .
- Jo në të gjitha rastet, dokumentohet që SAB ka marrë në shqyrtim regjistrin e riskut pranë njësisë së audituar dhe që audituesit të kenë dhënë vlerësimin, opinionin dhe rekomandimin përkatës të orjentuar për hartimin, rishikimin e përmirësimin e tij.
- Programi i angazhimit është miratuar nga K/Bordit të Administrimit, duke cënuar pavarësinë dhe krijuar vonesa në komunikimin në kohë të rezultateve të auditimit.
- Nuk janë respektuar kërkesat metodologjike lidhur me afatin e përcjelljes së Projekt raportit dhe Raportit përfundimtar tek subjekti i audituar.
- Të gjitha shtyrjet e afatit të kohës së kryerjes së auditimit, të miratuara, nuk janë shoqëruar me ndryshimet në programin përkatës të auditimit.
- Grupi i auditimit, gjatë fazës paraprake të angazhimit, nuk ka hartuar pyetsoret përkatës të kontrollit të brendshëm, për të identifikuar gjëndjen dhe dobësitë e kontrolleve të ngritura.

REKOMANDIMET

Gjatë vlerësimit të jashtëm të cilësisë të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në UBT, janë evidentuar gjetje në disa fusha/kritere që kërkojnë përmirësime në të ardhmen, duke adresuar rekomandimet konkrete të cilat konsistojnë në:

- përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm,
- rishikimin e përmbajtjes së Rregullores së brendshme të funksionimit të SAB, lidhur me parashikimin e linjës së komunikimit dhe raportimit të drejtëpërdrejtë tek Bordi i Administrimit.
- marrjen në shqyrtim të regjistrit të riskut pranë njësisë/strukturës së audituar.
- miratimin e Programit të Angazhimit nga drejtuesi i Njësisë së AB.
- hartimin e listës së kontrolleve dhe pyetsorëve përkatës të sistemit të kontrollit të brendshëm, gjatë fazës paraprake të angazhimit.
- ndjekjen e procesit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të adresuara nga SAB.

Opinion i Përgjithshëm

Grupi i Vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë së Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësorë Tiranë, me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm të pranuar, bazuar në vlerësimin e kritereve kryesore ISSPA (ISSPA 1100, ISSPA 1200, ISSPA 2000, ISSPA 2200, ISSPA 2300) dhe dytësore (ISSPIA 1000, ISSPIA 1300, ISSPIA 2100, ISSPIA 2400, ISSPIA 2500 dhe ISSPIA 2600) të grup standardeve të konsideruara shumë të

rëndësishme dhe Metodologjinë e “Vlerësimit të jashtëm të cilësisë, kur të gjitha standardet kryesore janë vlerësuar **me të gjelbër**, jep Opinionin e përgjithshëm:

E Gjelbër

Veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm është në përputhje të plotë me kuadrin rregullator dhe me standardet ndërkombëtare për praktikat profesionale të auditimit të brendshëm, por në disa fusha është i nevojshëm përmirësimi, ku dhe janë adresuar rekomandimet.

III.HYRJE

Në zbatim të “Planit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë së njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik për vitin 2022”, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm nr.23648/1, datë 31.12.2021 dhe mbështetur në kërkesat e Standardit 1312 “Vlerësimet e Jashtme” (jo më pak se një herë në 5 vjet), objekt i vlerësimit të jashtëm të cilësisë është veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm (SAB) në Universitetin Bujqësor Tiranë.

Sektori i Auditimit të Brendshëm në UBT, është ngritur në zbatim të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM-së nr.83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, është e organizuar dhe funksionon në nivel Sektor, përmban në organikën e saj 3 auditues (1 (një) Përgjegjës Sektor dhe 2 (dy) specialistë audit), brenda strukturës organizative të institucionit-UBT.

Mbështetur në strukturën organizative të UBT, SAB është e organizuar dhe funksionon si strukturë e vecantë, në përputhje me pikën 1/a, të neni 10, të ligjit Nr.114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në varësi direkte dhe i raporton Bordit të Administrimit, në cilësinë e titullarit të njësisë publike.

Në funksion të përmbushjes së objektivave të mësipërme të UBT, SAB ka përcaktuar objektivat e saj për të realizuar misionin dhe rolin e auditimit të brendshëm, si shtues vlere në këtë njësi publike dhe si këshillues i menaxhimit të lartë, paraqitur në Planet strategjike dhe vjetore 2020-2022, 2021 – 2023, nëpërmjet të cilave synon:

- Kryerjen e veprimtarisë së pavarur objektive dhe të bazuar në identifikimin, vlerësimin objektiv dhe menaxhimin e riskut.
- Vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrolleve në përmbushje të misionit të institucionit.
- Të minimizojë mundësitë për mashtrim, shpërdorim, abuzim dhe keqpërdorim të fondeve.
- Dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të UBT.
- Ndjekjen në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve të dhëna.

Objektivat e përcaktuara kanë shërbyer si bazë për hartimin dhe zbatimin e planeve strategjike dhe vjetore të veprimtarisë së kësaj njësie auditimi, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të rekomandimeve të adresuara.

Vlerësimi i fundit i veprimtarisë së këtij Sektori është kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), i cili për periudhën e vlerësuar nga data 01.01.2016 deri më 31.12.2017, në kreun VII “Mbi vlerësimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në UBT” të Raportit Përfundimtar, është shprehur për performancën e NJAB.

Vlerësimi i jashtëm i cilësisë bazohet në ligjin nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, aktet nënligjore, dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, të pranuar, duke përdorur “Metodologjinë e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.22 datë 06.03.2017, si dhe në zbatim të Programit të Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë nr. 380/1, datë 11.01.2022.

Qëllimi i misionit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë është të sigurojë përputhshmërinë e aktivitetit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm me grupin e standarteve dhe kuadrin e praktikave profesionale (ISSPA), si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e kësaj veprimtarie në të ardhmen.

Gjatë vlerësimit është përdorur “Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të cilësisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.22 datë 06.03.2017, duke u mbështetur në analizimin e shkallës së përputhshmërisë së veprimtarisë së NJAB-së, me kuadrin rregullaror në fuqi dhe parimet e parashikuara në një grup të caktuar standardesh ndërkombëtare të auditimit të brendshëm.

Objektivat e vendosura nga grupi i vlerësimit janë:

- Monitorimi dhe vlerësimi i realizimit të misionit të veprimtarisë së kësaj Njësie Auditimi të Brendshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar;
- Vlerësimi i efektivitetit dhe efijencës së këshillave dhe rekomandimeve të adresuara për subjektet e audituara, dhe;
- Përcaktimi i fushave që kërkojnë ndërhyrje për përmirësim.

Drejtimet e përcaktuara në programin e vlerësimit dhe të shqyrtuara nga grupi i vlerësimit janë:

1.Vlerësimi i veprimtarisë sipas kritereve të përcaktuara në Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë.

2.Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nga vlerësimi i kryer nga vlerësues të tjerë të jashtëm.

Grupi i punës për vlerësimin e veprimtarisë së njësisë shqyrtoi 5 (pesë) dosje/praktika auditimi, ku përzgjedhja e dosjeve u bazuan, në gjykimin mbi specifikat që kishin njësitë publike të audituara, me synim që ato të ishin sa më përfaqësuese për të dhënë një opinion mbi shkallën e zbatimit të standarteve në veprimtarinë audituese të kësaj njësie.

Për të përmbushur këtë kërkesë dhe për të identifikuar mundësitë për përmirësim, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ndërmorri këtë Vlerësim të Jashtëm të Cilësisë (VJC) mbi aktivitetin e auditimit të brendshëm në UBT, i cili shërben si një garanci e shtuar lidhur me cilësinë e punës së auditimit të brendshëm në të gjitha aspektet e saj të rëndësishme dhe gjeneron besueshmëri tek përdoruesit e punës së auditimit të brendshëm, si edhe në llogaridhënie.

Grupi i punës vlerësoi veprimtarinë e SAB duke trajtuar dhe argumentuar rast pas rasti gjetjet, për të cilat janë adresuar rekomandimet konkrete, mbështetur në shkallën e plotësisht të kërkesave të kriterëve të përcaktuara për çdo standard në Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë.

• STANDARD ISSPA 1000 - QËLLIMI, AUTORITETI DHE PËRGJEGJËSIA

Zbatimi i këtij standardi ka si qëllim që autoriteti dhe përgjegjësia e veprimtarisë së auditimit të brendshëm duhet të përkufizohet formalisht në Kartën e Auditimit të Brendshëm, të miratuar nga menaxhimi.

Karta e Auditimit të Brendshëm është dokumenti bazë që rregullon veprimtarinë audituese në Sektorin e Auditimit të Brendshëm (SAB). Ky dokument është hartuar nga SAB dhe është miratuar me Vendim nr.46, datë 14.06.2019 të Bordit të Administrimit të UBT-së “Për miratimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm dhe Programit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë të UBT”.

Grupi i vlerësimit nga shqyrtimi i këtij dokumenti evidenton se Karta e Auditimit të Brendshëm i përmbahet në formë dhe përmbajtje përcaktimeve të kuadrit rregullator në fuqi (ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100/2016), duke patur në përmbajtje të saj rregulla të mjaftueshme specifike lidhur me pavarësinë dhe objektivitetin e AB-së.

Dokumenti ka të përcaktuar objektin e kartës, misionin, statusin organizativ, qëllimin, objektin e punës dhe veprimtarisë, autoritetin, parimet e pavarësisë dhe objektivitetit, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë, planin e auditimit, raportimin dhe monitorimin, si dhe sigurimin e cilësisë. Për periudhën objekt vlerësimi rezulton se Karta e AB është në përputhje me kërkesat ligjore dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm, por në kuadër të procesit të ndryshimeve të bëra në MAB dhe të miratuara me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, dokumenti nuk ka reflektuar në përmbajtjen e objektit të tij edhe përfshirjen e shërbimeve të këshillimit, të cilat i ofrohen njësisë publike si dhe atyre palëve të tjera jashtë saj.

Përditësimi i Kartës së AB, kërkon përfshirjen e këtij elementi në objektin e saj, në mënyrë që menaxhimi i lartë i UBT-së të kuptojë plotësisht rolin e auditimit të brendshëm në këtë Institucion të Arsimit të Lartë (IAL).

SAB pranë UBT në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së tij, si dhe përmbushjes së objektivave të vendosura ka hartuar rregulloren e “*Degës së Auditimit të Brendshëm*”, miratuar nga Rektori i UBT-së, me shkresën nr.1451, datë 18.07.2017.

Referimi në standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm është evident në të gjitha dokumentet bazë për funksionimin e këtij Sektori të Auditimit të Brendshëm në UBT.

Nga grupi i vlerësimit evidentohet se në rregulloren e Njesisë të Auditimit të Brendshëm, trajtohet miratimi nga ana e titullarit të institucionit e planeve strategjike dhe vjetore, inicimi nga ana e tij të shërbimeve të këshillimit, miratimi i raportit vjetor, etj, detyrime të cilat rrjedhin nga funksionet dhe kompetenca që ka Drejtuesi i SAB-së për të përmbushur këto detyra, por pa u përcaktuar periudha e saktë sesi duhet të realizohet ky komunikim me titullarin e institucionit të UBT-së me këtë njësi auditimi.

Përgjegjësja e SAB dhe stafi i audituesve të brendshëm pohojnë gjatë bashkëbisedimit se aksesit në informacion, dokumentacion, mjete dhe punonjës në çdo njësi subjekt auditimi ka qenë i pakufizuar. Po kështu edhe në dokumentacionin e shqyrtuar, të Raportit mbi veprimtarinë e AB në UBT për vitin 2020 (shkresa nr.95/3, datë 12.02.2021 “Dërgohet raporti i veprimtarisë së Njesisë të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020”), në Kapitullin VIII “Konkluzione mbi problematikën e punës audituese”, nuk u konstatuan shqetësime lidhur me kufizimin në përdorimin e dokumentacionit, mjeteve dhe punonjës, gjë që ka krijuar kushte që konkluzionet e audituesve të mbështeten në dokumentacion të besueshëm.

Stafi auditues në këtë njësi :

- ✓ zotëron njohuri të mira mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre, të parashikuara në kuadrin ligjor rregullator si: ligji nr.114/2015, Manuali i Auditimit të Brendshëm, Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Kodi i Etikës, kjo falë edhe eksperiencës shumë vjeçare në fushën e auditimit.
- ✓ duke konsideruar përvojën e gjatë në profesion të tyre, vlerësojmë se audituesit kanë të qartë dallimin ndërmjet shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit, si dhe njohin rolin e menaxhimit të lartë për zbatimin e rekomandimeve të adresuara në raportet e hartuara.
- ✓ ka ofruar vetëm shërbimin e sigurisë dhe jo atë të shërbimit të këshillimit.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të marrë masa për përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm, pas ndryshimeve të Manualit të AB (miratuar me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë), miratimin e saj tek Bordi i Administrimit dhe përcjelljen pranë DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të propozojë plotësimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij, lidhur me komunikimin dhe të drejtën e raportimit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek Bordi i Administrimit.

Rekomandim: Bordi i Administrimit të reflektojë dhe të parashikojë në Rregulloren e brendshme të funksionimit të tij, kompetencat dhe funksionet ndaj Njesisë së auditimit të brendshëm.

Plani Strategjik “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm” përfaqëson një nga veprimtaritë më të rëndësishme për shërbimin e auditimit të brendshëm dhe është një element i kontrollit të brendshëm, i cili hartohet për t’i siguruar Titullarit të njësisë publike, që të gjitha veprimtaritë, proceset dhe operacionet në Institucion dhe në strukturat/njësitë e tij mbulohen me auditim nga funksioni i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Objektivat strategjik të institucionit dhe vlerësimi i riskut në mjedisin ku vepron Universiteti Bujqësor, kanë qënë mbështetje në formulimin dhe hartimin e Planit Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm, ku janë përcaktuar prioritetet dhe janë vendosur objektivat në drejtim të përmbushjes së qëllimeve dhe arritjes së objektivave të SAB përgjatë periudhës strategjike që planifikohet.

Këto plane, në zbatim të pikës 19 të nenit 4, gërmës ç) të nenit 12, gërmës c) të nenit 14 të ligjit 114/2015 dhe gërmës “k” të nenit 15 “Bordi i Administrimit” të Statutit të UBT, konformë kompetencës të miratimit të tyre, janë përcjellë për miratim tek Bordi i Administrimit, në cilësinë e Titullarit të njësisë publike, respektivisht me shkresën “Për miratimin e Planit Strategjik dhe Vjetor”, nr.2287/1, datë 15.10.2019 dhe nr.1564/1, datë 12.10.2020.

Respektivisht sa sipër Bordi i Administrimit, me :

- ✓ Vendimin nr 69, datë 22.10.2019 ka miratuar “Planin strategjik dhe vjetor për periudhën 2020-2022”,
- ✓ Vendimin nr 74, datë 15.10.2020 ka miratuar “Planin strategjik dhe vjetor për periudhën 2021-2023”.

Referuar detyrimit përcaktuar në gërmën c) të nenit 14 të ligjit 114/2015, këto plane janë përcjellë pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (DH/AB), respektivisht me shkresën nr.2287/3, datë 23.10.2019 (tej afatit ligjor) dhe nr.1564/3, datë 20.10.2020.

Nga vlerësimi i kryer rezultoi se SAB gjatë procesit të planifikimit të angazhimeve:

- ✓ i është përmbajtur kërkesave metodologjike të përcaktuara në kuadrin rregullator të miratuar;
- ✓ ka zbatuar një metodologji të bazuar në risk, ku për vlerësimin e risqeve i është referuar :
 - a. identifikimit dhe rezultateve të vlerësimit të sistemeve, nga auditimet e mëparshme;
 - b.formateve standard nr 1-3 dhe nr 4-5 të Manualit të AB.
- ✓ ka marrë në konsideratë shtrirjen e auditimit në të gjitha strukturat brenda UB, tek të cilat ka detyrimin për t’i audituar si dhe në të gjitha fushat respektive të auditimit, të përfshira në fushëveprimin e veprimtarisë së institucionit;
- ✓ ka synuar respektimin e frekuencës të mbulimit me auditim të të gjitha strukturave/njësive mësimore dhe ndihmëse, të shërbimit dhe administrative, ndihmëse brenda institucionit dhe subjektet e varësisë;
- ✓ ka marrë në konsideratë burimet njerëzore në dispozicion në momentin e hartimit të këtyre planeve;
- ✓ universin e auditimit e ka përfaqësuar me të gjitha strukturat, njësitë përbërëse të Universitetit dhe sistemet më të rëndësishme të tyre për tu audituar, të përfshira në fushëveprimin dhe aktivitetet e tyre, tek të cilat kjo njësi ka detyrimin për auditim dhe që janë objekt i auditimit;
- ✓ referuar organigramës dhe strukturës së UB (miratuar me Vendimin nr.88, datë 29.12.2020 të Bordit të Administrimit) dhe Neneve 5-11 të Statutit të UBT (ku përcaktohen respektivisht njësitë kryesore,bazë, ndihmëse dhe degët që funksionojnë në UBT) tek Pasqyra nr.1,

Përgatitja dhe nënshkrimi i Deklaratës së Pavarësisë / Konfliktit të Interesit për çdo angazhim auditimi është një ndër masat parandaluese për shmangien e kërcëimit të pavarësisë apo konfliktit të interesit. Deklarata e pavarësisë gjendej e nënshkruar nga audituesit, plotësimi kryhej përpara fillimit të çdo angazhimi dhe si nga audituesit, por dhe nga Drejtuesi i SAB ku nuk është evidentuar apo komunikuar ndonjë rast konflikt interesi. Gjatë periudhës objekt vlerësimi nuk u evidentuan raste të konfliktit të interesave.

✓ nuk u evidentuan raste të përfshirjes dhe angazhimit të audituesve në detyra të tjera apo veprimtari operationale (jo veprimtari audituese) që të kenë cënuar objektivitetin, kompetencën dhe paanësinë, duke respektuar germa “a” të nenit 17 “Kufizimet në veprimtarinë e audituesve të brendshëm”, të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,

✓ audituesit e brendshëm nuk kanë qënë të përfshirë në grupet për hartimin e procedurave për vendosjen apo funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, por është treguar kujdesi i duhur për dhënien e rekomandimeve sa më objektive për përmirësimin e procedurave, etj.

✓ aksesit në informacionin që shqyrtohet në njësitë e audituara ka qënë i pakufizuar, pra nuk kanë patur vështirësi të këtij lloji, por nga ana e tyre u theksua se janë të qartë për mënyrën e zgjidhjes të këtyre situatave, (nëpërmjet komunikimit me titullarin e subjektit të audituar). Edhe në “Raportin mbi veprimtarinë e SAB-së”, nuk përmenden problematika të hasura në këtë drejtim,

✓ audituesit e brendshëm, nga eksperiencia që zotërojnë, njohin mirë procesin e identifikimit dhe raportimit të dëmtimeve të pavarësisë dhe objektivitetit,

✓ audituesit e brendshëm kishin njohuri rreth parashikimeve ligjore të Kodit Etik, ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të ndryshuar dhe ligjin 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar, dhe shmangien e konfliktit të interesi të shkaktuar nga pranimi i dhuratave që influencen në pavarësinë dhe integritetin e audituesve,

✓ pozicioni i audituesve të brendshëm në këtë Njësi, është i konsoliduar (2 prej tyre kanë 11-12 vite pune, të punësuar si auditues në këtë institucion,). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve pranë SAB-së, evidentohet se punonjësit nuk zotërojnë eksperiencia të mëparëshme punësimi në Departamentet/Drejtoritë apo Fakultetet e UBT-së, pra nuk janë transferuar nga njësitë operationale, por megjithatë kanë njohuri të plota lidhur me respektimin e periudhave të mosangazhimit në misione auditimi sipas përcaktimeve në pikën 2/a të nenit 18 të ligjit 114/2015.

✓ stafi i auditimit në këtë njësi nuk ka pasur ndryshim të përbërjes për periudhën objekt vlerësimi.

✓ nga ana e tyre, u konfirmua që njohin procedurat dhe detyrimin ligjor, për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe informacionit që ata disponojnë për shkak të funksionit që kryejnë dhe përdorimin e tij vetëm për qëllimet e auditimit.

Grupit të vlerësimit ju vu në dispozicion Urdhëri i Administratorit nr.62, datë 12.01.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS) të Universitetit Bujqësor të Tiranës”, si një detyrim në përmbushje të parashikimeve në pikën 2, të nenit 27, të ligjit nr.10296, datë 18.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, ku konstatohet se Drejtuesi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm nuk është anëtar në përbërje të GMS-së. Ky i fundit luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, ç’ka kërkon që drejtuesi i SAB duhet të përfshihet në përbërjen e këtij grupi dhe të

Audituesit e brendshëm të punësuar në NJAB pranë UBT :

1.plotësojnë kërkesat e punësimit, përcaktuar në pikën 2 të nenit 11 të ligjit nr.114/2015”Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, pasi plotësojnë kriterin e vjetërsisë, mbi 5 vjet në profesion dhe mbi 3 vjet pune si auditues të brendshëm.

Punonjësi i ri i emëruar, në respektim të detyrimit përcaktuar në gërmën “ç” të pikës 2 të nenit 11, brenda periudhës 2 vjeçare i është nënshkruar procedurës së certifikimit dhe në vitin 2021 u certifikua si “Auditues i Brendshëm”.

2 kanë një eksperience pune në fushën e auditimit që varion nga 3.6 deri 12 vite dhe vjetërsi pune në profesion nga 5.5 deri në 33 vite;

3.zotërojnë aftësitë e nevojshme, përvojën dhe kompetencën e duhur për kryerjen e angazhimit të auditimit si dhe përditësojnë rregullisht njohuritë e tyre. Vërehet se 2 nga 3 punonjëset aktuale të SAB-së, duke patur eksperiencë mbi 10 vite në këtë fushë zotërojnë njohuri të sakta lidhur me përcaktimet ligjore, mbi aftësitë dhe kompetencat që duhet të shfaqin gjatë kryerjes së angazhimeve, duke i dhënë mbështetje dhe punonjëses më me pak përvojë pune, e cila është ndihmuar dhe trajnuar nga Përgjegjësja e Sektorit dhe përgjegjësja e grupit, për tu përfshirë në dinamikën e zgjidhjes së problematikave dhe çështjeve të veçanta që ndeshen gjatë kryerjes së auditimeve.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dosjeve të hartuara për çdo angazhim, rezulton se, personeli auditues i UBT-së, ka planifikuar dhe kryer veprimtarinë bazuar në respektimin e kërkesave metodologjike përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, konkretisht :

1. Lidhur me hartimin e programit të angazhim auditimit, grupi i vlerësimit konstatoi se:

Programi i Angazhimit:

- ✓ është strukturuar konformë formatit standard nr.8,të Manualit të AB,
- ✓ ka të përcaktuara qartë objektivat e auditimit dhe objektin e misionit, metodat dhe llojin e auditimit, drejtimit e angazhimit, periudhën e auditimit, afatin dhe referencat ligjore,
- ✓ ka përfshirë si pikë të vecantë të tij dhe “Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme”, si kërkesa që parashikohen në kapitullin IV të MAB-së.
- ✓ ka të parashikuar, si drejtim të tij, vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK-së),

2.Janë përcaktuar ndarjet e pikave/drejtimeve të auditimit për çdo auditues, si një proces i cili dokumentohet më vehte, konform pikës 4.1.1.2 të Manualit të AB.

3. Struktura e Raporteve të auditimit (Projektit dhe Raportit përfundimtar) është konformë formatit të përcaktuar në Manualin e AB, të ndryshuar.

4. Nuk është respektuar afati ditor (10 ditë pune) i përcjelljes së projekt raportit pranë njësisë së audituar pas përfundimit të angazhim auditimit (Tabela nr.2);

Përfundimisht sa sipër, audituesit e brendshëm jo vetëm njohin procedurat e përcaktuara në Manualin e AB dhe metodologjinë për auditimin e fushave dhe sistemeve të veçanta, pasi janë trajnuar për të aplikuar këtë metodologji, por dhe në praktikë kanë ndjekur me rigorozitet procedurat sipas fazave dhe etapave të auditimit.

po auditohen (Formati Standard 5), në përputhje me specifikat dhe objektin e veprimtarisë së audituar, si dhe “Formulari i vlerësimit të përgjithshëm të riskut” (Formati Standard 8), si një dokument që shërben për të mbështetur hartimin e planit strategjik dhe vjetor të SAB-së.

- Dosjet administrojnë testet mbi sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm dhe rezultatet me vlerësimin e tyre.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1200, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:



- E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin

• STANDARD ISSPA 1300 SIGURIMI I CILËSISË DHE PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT

Sipas këtij standardi, drejtuesi i njësisë së auditimit duhet të hartojë dhe të përditësojë programin për vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ky program bën të mundur vlerësimin e pajtueshmërisë së veprimtarisë audituese me kuadrin rregullator në fuqi, i cili ka pranuar standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, nëpërmjet vlerësimit të efikasitetit e efektivitetit të kësaj veprimtarie duke identifikuar mangësitë e adresuar përmirësime.

Sigurimi i brendshëm i cilësisë përfshin opinionin e drejtuesit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm lidhur me vlerësimin e riskut, planifikimin, kryerjen e angazhimit dhe raportimin e veprimtarisë audituese, opinion i cili sigurohet sipas përcaktimeve në komponentët:

- Monitorimi i vazhdueshëm, nga secili auditues në cilësinë e përgjegjësit të grupit, apo edhe anëtarit të grupit;
- Vetëvlerësimi periodik nga njësia e auditimit të brendshëm, i cili duhet të bëhet bazuar në kriterë të përcaktuara të vlerësimit të cilësisë, në lista kontrolli të hartuara dhe miratuara për këtë qëllim, që lidhen me mbikqyrjen e angazhimeve, përzgjedhjen e dokumentacionit të punës që do të rishikohen, vlerësimin e performancës p.sh afatit kohor dhe rekomandimeve të dhëna e të pranuar;
- Sondazhi i subjektit të audituar (feedback), i cili duhet të fokusohet në kriterë të përcaktuara të cilësisë së veprimtarisë audituese,

përcaktuar në kapitullin VII “Sigurimi i cilësisë së punës së auditimit të brendshëm”, të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Nga vlerësimi i dokumentacionit, konstatohet se :

1.Sektori kishte ndërtuar sistemin e kontrollit të brendshëm të cilësisë, e për rrjedhojë kishte zbatuar kërkesat e parashikuara në Manualin e AB, si një masë e domosdoshme e cila konsiston në miratimin nga Bordi i Administrimit (BA), të “Programit për sigurimin e brendshëm të cilësisë të SAB”, me vendimin nr.46, datë 14.06.2019,

Metodologjia e vlerësimit të cilësisë dhe “*Programi për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe përmirësimit*” përfshin monitorim të vazhdueshëm të veprimtarisë, vetë-vlerësime periodike,

dobishme. Përcaktimi i indikatorëve të matjes së performancës së veprimtarisë audituese, synon vlerësim të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, në funksion të raportimit të rezultateve të sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Në kreun VI “*Monitorimi i sistemit dhe sigurimit të cilësisë*” të raportit vjetor për vitet 2020 dhe 2021, Sektori i AB-së është shprehur se sigurimi i cilësisë është kryer në të gjitha etapat e auditimit, pra dokumentohet plotësisht raportimi i këtij procesi mjaft të rëndësishëm për veprimtarinë audituese.

Pyetëtori i reagimit ndaj angazhimit ju është dërguar zyrtarisht subjekteve të audituara njëkohësisht me dërgimin e Raportit Përfundimtar, pyetëtori kthehej i plotësuar në çdo rast dhe gjendej si pjesë e inventarit të dosjes.

Ndër subjektet e audituara, për të realizuar intervistën, u përzgjodh Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, ku intervista u zhvillua me Administratorin e Fakultetit. Intervista kishte në fokus vlerësimin e profesionalizmit të audituesve, nga ku u theksua vlera dhe dobia e rekomandimeve që ishin adresuar në auditimin e fundit, ndërsa lidhur me statusin e rekomandimeve u evidentua se janë në proces zbatimi. Opinioni i tyre mbi profesionalizmin e AB në dhënien e rekomandimeve ishte konform kërkesave të bazës rregullative në fuqi, duke respektuar Kodin Etik.

✓ Nga SAB, ishin kryer vlerësime të brendshme, në këto kushte përdorimi i shprehjes “në përputhje me standardet ndërkombëtare”, do të ishte i pa nevojshëm sepse kjo deklaratë duhet të mbështetet së paku nga rezultatet e dy vlerësimeve të jashtme. (Psh. në rastet tek aneksi A/3 pyetja 11 është përgjigjur me (1) “nuk ka patur raste të mospërputhjes me standardet ndërkombëtare”, ndërkohë që kjo pyetje nuk duhet të marri përgjigje pozitive, pasi nuk është në konformitet me këtë kriter.

Opinioni i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 1300, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:

 - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin

• **STANDARD ISSPA 2000 - MENAXHIMI I VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Sipas këtij standarti drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të menaxhojë me efektivitet veprimtarinë e auditimit të brendshëm, për të siguruar se auditimi i brendshëm i shton vlerë njësinë publike.

Stafi i njësisë së auditimit, duhet në mënyrë të vazhdueshme të përmbush qëllimin dhe përgjegjësitë e përfshira në Kartën e Auditimit të Brendshëm, të veprojë në përputhje me standardet dhe Kodin e Etikës për Audituesit e Brendshëm, si dhe të marrë parasysh ndryshimet në njësinë publike.

- Në planet strategjike e vjetore respektive, është parashikuar mbulimi me shërbim auditimi i të gjithë universit të auditimit dhe shtrirjen e veprimtarisë së auditimit pranë 9 subjekteve të identifikuar për auditim, duke i dhënë prioritet sistemeve sipas nivelit të riskut (të lartë, të mesëm, të ulët).
- Frekuenca e kryerjes së auditimeve është përcaktuar duke marrë në konsideratë mbulimin me auditim të të gjitha sistemeve/ fushat, proceset dhe aktivitetet e identifikuar me nivel risku.
- SAB tek rubrika “Identifikimi i subjekteve” në Planin Strategjik respektiv, referuar organizimit të UBT, me Njësitë e varësisë me buxhet me vete, ka identifikuar subjektet për auditim.
- SAB administron të plotësuar formatet standard, Formatin nr. 1 “Pyetësor vlerësimi për mjedisin e kontrollit të brendshëm “ dhe Formatin nr.2 “Pyetësor për Planin Strategjik”, si pjesë të procesit të planifikimit fillestar, për të identifikuar riskun e vlerësuar në çdo sistem apo nënsistem që do të auditohet.
- SAB në këto plane ka përfshirë për auditim të gjitha njësitë përbërëse të UBT (Rektoratin dhe Fakultetet) dhe njësitë ndihmëse e të shërbimit në funksion të procesit mësimor-shkencor, si subjekte auditimi ,duke planifikuar pranë tyre, auditim të shërbimit të sigurisë të llojit “Auditim përputhshmërie” dhe “Auditim të kombinuar“, mbi bazë të vlerësimit të riskut. Për secilin subjekt/strukturë janë specifikuar fushat përkatëse për t’u audituar.
- Sistemet me risk të lartë (Struktura Administrative e Rektoratit) janë parashikuar për tu audituar në vitin pasardhës, konformë kërkesave metodologjike, pikës 3.1.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet që subjektet me risk të lartë duhet të auditohen çdo vit.

Përvec sa sipër, evidentojmë që kjo Njësi objektivat afatshkurtra i kishte të orjentuara :

- Kryerjen e auditimeve sipas planit të miratuar dhe në përputhje me Ligjin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën profesionale të Auditimit të Brendshëm, duke ruajtur frekuencën e auditimeve, vlerësimin e riskut.
- Vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe përmirësimin e tij nëpërmjet rritjes së cilësisë së rekomandimeve.
- Dhënies prioritet të sistemeve/fushave të vlerësuara me risk të lartë.
- Ndjekjes në vazhdimësi të rekomandimeve të adresuara, nga auditimet e kryera dhe bashkëpunimi me menaxhimin për rritjen e nivelit të zbatimit të tyre.

Realizimi i planit sipas viteve paraqitet:

- Në planin vjetor (fillestar) të auditimit për vitin 2020, ishin parashikuar 5 misione auditimi të shërbimit të sigurisë, nga të cilat 4 të llojit “Auditim të përputhshmërisë” dhe 1 “Auditim i kombinuar”. Për shkak të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm, konkretisht :
 1.Shpalljes së gjëndjes të fatkeqësisë natyrore, sipas VKM nr.243, datë 24.03.2020, i ndryshuar,Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156, datë 10.03.2020 ”Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, i ndryshuar,
 2.Përfundimit të dy misioneve të auditimit të mbartur nga viti i kaluar,

programit buxhetor afatmesën (periudha 2017-2019), në Regjistrin e Riskut janë regjistruar të gjitha risqet e identifikuar, vlerësimi dhe kontrolli mbi ngjarjet/situatat që kanë ndikim në pesë objektivat kryesore të UBT. Dokumentohet që ky Regjistër nuk është përditësuar, referuar ndryshimeve thelbësore të mjedisit të riskut.

Sektori i AB, konformë detyrimit përcaktuar në pikën 2 të nenit 11 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ku shprehet që : *Menaxherët e strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë, si dhe bazuar në gjykimin profesional, ka hartuar e posedon “Regjistrin e riskut”, ku identifikohen risqet për dy objektivat kryesore, gjatë veprimtarisë audituese dhe ndikimin e tyre në arritjen e objektivave.*

SAB në planin strategjik dhe vjetor, respektiv të veprimtarisë së saj, si objektiv strategjik ka paraqitur :

✓ *vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontroleve në përmbushje të misionit të UBT;*

✓ *kryerjen e veprimtarisë së pavarur objektive dhe të bazuar në identifikimin, vlerësimin objektiv dhe menaxhimin e riskut.*

Dokumentohet që në subjektet/strukturat tek të cilat audituesit e brendshëm kanë identifikuar risqet kryesore apo fushat të cilat kanë nevojë për përmirësim, si në :sistemin e prokurimeve publike dhe shitjeve me ankand, sistemin e menaxhimit të aktiveve, sistemin e pagesave, fushën e specializimeve, kanë vënë në dijeni drejtuesin e subjektit/strukturës për marrjen e masave për menaxhimin e minimizimin e riskut nëpërmjet rekomandimeve të adresuara.

Në dosjet e përzgjedhura për shqyrtim u konstatua se:

✓ SAB në programin e auditimit ka parashikuar si drejtim të vecantë të tij vlerësimin e komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, ku si komponent të MFK është trajtuar dhe “Menaxhimi i riskut” pranë strukturës së audituar.

✓ Në asnjë Raport auditimi, grupi i punës nuk është shprehur :

-nëse struktura e audituar ka hartuar (ose jo) regjistrin e riskut apo ka ai nevojë për përmirësim,

- nëse regjistri i riskut, identifikimi i risqeve, rezultatet e vlerëimit të tyre dhe efektiviteti i proceseve të kontrollit në menaxhimin e riskut, pranë strukturës së audituar, është vlerësuar nga auditimi i brendshëm.

Konkretisht në Raportet respektive të auditimit, kjo rubrikë ka këtë përshkrim :

1.Auditimi i sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar- *Institucioni duhet të vlerësojë risqet e mundshme, si dhe të propozojë marrjen e masave të duhura për strukturat përgjegjëse.Këtu përmendim vlerësimin e risqeve për detyrimet e reja, menaxhimin e riskut të aktiveve,etj.*

2.Auditimi i sistemit të menaxhimit të Burimeve Njerëzore-*Përsa i përket menaxhimit të riskut përgjithësisht është menaxhuar risku gjatë kryerjes së pagesave.*

3. Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit- *FBU duhet të hartojë regjistrin e riskut, i cili duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut të UBT...Nga përshkrimi i dhënë evidentohet që FBU nuk ka hartuar këtë regjistër dhe për këtë gjetje, audituesi i brendshëm ka adresuar*

“Qëllimi i auditimit të brendshëm” dhe “Përgjegjësia “ tek Karta e Auditimit të Brendshëm, ku përcaktohet që : *auditimi i brendshëm synon të përmirësojë dhe mbrojë vlerat e institucionit, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.*

Standartet e auditimit të brendshëm, interpretojnë se në rast se duhet të ketë një rishikim të planit vjetor të auditimit, është e rëndësishme që ky rishikim të bëhet gjatë vitit, pasi të përfshihet edhe menaxhimi i lartë.

Grupi i vlerësimit pas shqyrtimit të dokumentacionit, për periudhën objekt vlerësimi, evidentoi se Plani vjetor i auditimit është monitoruar në mënyrë periodike dhe ka patur rishikim të tij për vitin 2020, për shkak të shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, të shkaktuar nga COVID-19.

Plani i ndryshuar :

a. përmban argumentimin dhe nevojën e këtij rishikimi i cili është miratuar nga titullari i njësisë publike- Bordi i Administrimit, me Vendimin nr.73, datë 15.10.2020 “Për miratimin e ndryshimit të planit vjetor të auditimit për vitin 2020”.

b. është dërguar zyrtarisht pranë DH/AB me shkresën nr.1627/2, dt 20.10.2020,

c.është shoqëruar me Pasqyrën nr 3 “Plani vjetor i angazhimeve për vitin 2020” (ishte dhe bëhet)

Drejtuesi i SAB:

✓ gjatë planifikimit të misionëve dhe aktiviteteve për vitet 2020 dhe 2021, ka analizuar burimet e disponueshme njerëzore mbi bazën e të cilave është përcaktuar numri i subjekteve të identifikuar për tu audituar, duke siguruar dhe një shpërndarje të përshtatshme, të mjaftueshme dhe efektive, për përmbushjen e planit të miratuar.

✓ në asnjë rast nuk ka parashikuar përfshirjen e punonjësve të tjerë jo-auditues/ ekspert (me profesionin inxhinier, IT, ose me njohuri specifike nga fusha që do të auditohet), të punësuar në drejtoritë/strukturat pranë UBT, pasi vlerëson aftësitë profesionale të lidhura me identifikimin, vlerësimin e riskut dhe njohuritë bazë për sistemet/fushat.

✓ gjatë zbatimit të planit të auditimit për vitet 2020 e 2021,ka bërë vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së burimeve njerëzore në dispozicion dhe nuk konstatohet që NJAB të ketë evidentuar problematikë lidhur me numrin e audituesve në dispozicion për realizimin e planit vjetor.

✓ në Raportin Vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për periudhën e vlerësuar, në rubrikën “Analiza e kapaciteteve audituese”, nuk ka evidentuar problematika lidhur me funksionimin e Njësisë. Të gjithë punonjësit e Sektorit të AB janë të diplomuar, përkatësisht dy punonjës në shkencat ekonomike dhe një punonjës në shkencat juridike, janë të certifikuar me titullin Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik, sipas kërkesave ligjore.

✓ ka raportuar periodikisht tek titullari i njësisë publike-Bordi i Administrimit, mbi veprimtarinë e auditimit të brendshëm, nëpërmjet: diskutimit dhe miratimit të planeve strategjike dhe vjetore, raportit vjetor të veprimtarisë dhe raporteve të auditimit të cilat i janë dërguar pas çdo auditimi të kryer, shoqëruar me Memon të përgatitur lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e adresuara sipas sistemeve.

Karta e Auditimit të Brendshëm (respektivisht kreu VI Përgjegjshmëria” dhe kreu IX “Raportimi dhe monitorimi”) dhe Rregullorja e Degës së Auditimit të Brendshëm, përcaktojnë detyrimin e

• STANDARD ISPP/IA 2100 - NATYRA E PUNËS

Qëllimi i këtij standardi është që veprimtaria e auditimit të brendshëm duhet të vlerësojë dhe të kontribuojë në përmirësimin e proceseve të qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe proceseve të kontrollit, duke përdorur një qasje sistematike, të disiplinuar dhe të bazuar në risk.

Stafi i SAB në UBT, duke njohur mirë objektivat, aktivitetet, proceset dhe sistemet e ngritur të kontrollit pranë strukturave të institucionit, për të cilat realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, ka përcaktuar universin e auditimit, i cili është i qëndrueshëm dhe i menaxhueshëm.

Nga dokumentacioni i vlerësuar, evidentohet që Sektori i AB ka marrë në shqyrtim dhe ka monitoruar në vazhdimësi procesin e implementimit të rekomandimeve të dhëna, për tu siguruar që veprimet korrigjuese janë ndërmarrë dhe janë efektive, duke përfshirë në çdo program angazhimi, si drejtim të veçantë të tij *“zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”*.

Në zbatim të kërkesave të ligjit 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” neni 12, pika d) dhe neni 14, pika iv) si dhe mbështetur në pikën 4.1.13.2 dhe 4.1.13.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm *“Përgjegjësia e njësisë për të zbatuar rekomandimet e AB”* dhe faktit që rekomandimet e adresuara kanë të bëjnë me fusha dhe sisteme të vlerësuara me nivel të mesëm/lartë risku dhe prioriteti, konstatohet që :

1. Subjektet e audituara kanë hartuar dhe përcjellë, brenda afatit ligjor të miratuar, pranë SAB, Planin e Veprimit të miratuar, ku është përcaktuar afati e struktura/personi përgjegjës për zbatim e rekomandimeve dhe reagimet e menaxhimit, si dhe disa prej tyre kanë raportuar mbi masat e marra për zbatimin e Plan Veprimit.
2. Sektori i AB, ka kryer monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi, nëpërmjet komunikimit me email (pa program auditimi) drejtuar drejtorëve të drejtorive dhe Administratorit të UBT, duke ju kërkuar informacion apo/raportim mbi ecurinë dhe progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve të adresuara, sipas statutit të tyre (i realizuar, në proces realizimi dhe i pa realizuar) dhe afateve të përcaktuara në planin e veprimit, problematikat e hasura në rastet e moszbatimit të tyre, të vërtetuar me dokumentacionin justifikues. Në përfundim të këtij procesi është hartuar informacioni mbi *“Rezultatet e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve”*, me vlerësimet përkatëse sipas statusit të rekomandimeve, drejtuar K/Bordit të Administrimit (Memo nr.36/2, date 03.02.2020- për angazhimet e kryera gjatë vitit 2018 dhe 2019 dhe Informacioni më datë 03.02.2021- për angazhimet e kryera gjatë vitit 2019 dhe 2020).
3. Në zbatim të Kapitullit II dhe III të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.42, datë 27.10.2020 *“Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”*, SAB me Programin e Angazhimit nr.490, datë 12.03.2021, ka kryer auditimin me objekt : *Vlerësimi i statutit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e vitit 2020*, pranë 3 subjekteve të audituara.

Qëllimi kryesor i shërbimit që ofrojnë audituesit e brendshëm pranë UBT, sipas përcaktimit në Kartën e AB është *“Të përmirësojë dhe të mbrojë vlerat e institucionit, duke ndihmuar UBT, për të aritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes”*.

Në vijim, pas testimit të sistemeve të mësipërme (të vlerësuar me risk të lartë), në raportet e auditimit, nuk ka gjurmë që audituesit e brendshëm :

- të kenë dhënë opinionin mbi: rezultatet e testimeve, gjëndjen dhe vlerësimin e kontroleve ekzistuese,
- të kenë marrë në shqyrtim ekzistencën dhe plotësimin e *regjistrit të riskut* pranë njësisë së audituar,
- të kenë dhënë opinionin dhe rekomandimet përkatëse të orjentuara për : hartimin e regjistrit të riskut, rishikimin e tij dhe forcimin e përmirësimit e aktiviteteve të kontrollit me qëllim minimizimin e riskut.

Përfundimisht, jo në të gjitha rastet, dokumentohet që SAB ka marrë në shqyrtim regjistrin e riskut pranë njësisë së audituar dhe që audituesit kanë dhënë vlerësimin, opinionin dhe rekomandimin përkatëse të orjentuara për hartimin, rishikimin e përmirësimit e tij.

✓ audituesit e brendshëm kanë dokumentuar kryerjen e testimeve mbi vlerësimin e funksionimit dhe efikasitetin e sistemeve kryesore të kontrollit të brendshëm sipas parashikimeve në dokumentacionin e procedurës, për të identifikuar përparësitë apo dobësitë e tyre, dokumentuar këto procese hap pas hapi në dosje.

Letrat e punës gjurmojnë/evidentojnë rezultatet e testeve të punës së auditimit.

Përfundimisht sa sipër, veprimet e kryera nga audituesit e brendshëm për testimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe dorëshkrimet e mbajtura, lënë gjurmë dhe dokumentojnë gjithë procesin e vlerësuar për dhënien e opinionit mbi funksionimin e sistemeve të vlerësuara.

Në raportet e auditimit evidentohet që audituesit:

✓ kanë shqyrtuar sistemet kryesore të kontrollit të brendshëm, ku për çdo sistem të vlerësuar kanë paraqitur gjetjet dhe në vijim rekomandimet përkatëse, si dhe pas çdo sistemi apo fushe të audituar, kanë dhënë vlerësimet e opinionet përkatëse mbi efektivitetin dhe përshtatshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, (mbështetur në evidencën përkatëse),

✓ bazuar në gjetjet, të mbështetura në evidencën përkatëse, kanë dhënë një opinion / vlerësim të përgjithshëm mbi të gjitha sistemet e ngritura në strukturën e audituar, se si ato funksionojnë dhe si kanë ndikuar ato në përdorimin me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet të aktiveve në dispozicion.

✓ kanë dhënë opinionin mbi rezultatet e vlerësimit të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm , si tek “ Përmbledhja ekzekutive” dhe në fund të Raportit tek rubrika “Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit“, duke adresuar rekomandimet përkatëse për vendosjen e kontroleve të duhura dhe efektive. Me këtë vlerësim të sistemeve është informuar jo vetëm drejtuesi i strukturës/njësisë së audituar nëpërmjet Raportit Final të Auditimit (tek Përmbledhja Ekzekutive dhe rubrika “Opinion i përgjithshëm mbi funksionimin e sistemit”) por dhe titullari i njësisë publike- Bordi i Administrimit, nëpërmjet Memo-s “Mbi konkluzionet dhe përfundimet e angazhimit të auditimit”, në funksion kjo të misionit dhe rolit të auditimit të brendshëm që është “ *dhënia e sigurisë së arsyeshme për titullarin e njësisë së sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik*” (neni 5 “Misioni” i ligjit 114/2015).

burimeve të angazhimit. Programi duhet të bazohet në strategjitë, objektivat e njësisë publike dhe risqet e lidhura me angazhimin.

Përveç planit strategjik dhe vjetor, SAB në funksion të realizimit të planit vjetor të veprimtarisë audituese, për çdo angazhim auditimi ka hartuar programin e auditimit.

Përveç sa është trajtuar tek Standardi 1200, lidhur me hartimin e programit të angazhimit, konstatohet se:

1. Për çdo mision angazhimi, audituesit e brendshëm kanë hartuar Programin e Angazhimit, i cili përmbush plotësisht të gjitha kërkesat sipas formatit standard nr.8 të miratuar në Manualin e Auditimit, është nënshkruar nga grupi i auditimit por nuk është miratuar nga Drejtuesi i SAB. Programet e angazhimit paraqiten të miratuara nga K/Bordit të Administrimit, sipas përcaktimit në gërmën “k” të pikës 2 të nenit 15 të Statutit të UBT, ku shprehet : *Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore : miraton kartën e auditit financiar të UBT, vjetor dhe planin strategjik dhe si dhe programet e angazhimit.*

Grupi i vlerësimit konstaton se përcaktimi në statut ,lidhur vetëm me programet e angazhimit nuk është në pajtim me Formatin Standart nr. 8 në Manualin e AB, ku tregohet që ky program miratohet nga Drejtuesi i Njësisë së Auditimit.

Manuali i AB përcakton mënyrën e përmbushjes së kërkesave të këtij standardi, sipas të cilit Bordi i Administrimit në cilësinë e titullarit të njësisë publike, miraton Planin Strategjik dhe Vjetore të angazhimeve të auditimit. Duke ruajtur pavarësinë e NJAB, gjatë vitit ushtrimor, drejtuesi i NJAB organizon angazhimet individuale të auditimit të cilat janë miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin përkatës, në planin vjetor të veprimtarisë.

Bordi i Administrimit është përfituesi dhe përdoruesi i rezultateve të punës së auditimit. Në këtë këndvështrim, krahas sa më sipër, nënshkrimi i çdo dokumenti nga ana e Bordit, krijon vështirësi për komunikimin në kohë, para, gjatë dhe në përfundim të auditimit.

2. Për përgatitjen e çdo programi, grupi i auditimi është njohur dhe ka siguruar gjithë informacionin e nevojshëm, mbi funksionet dhe proceset që janë pjesë e aktivitetit të strukturës së audituar dhe fushat me risk të lartë.

3. Referuar përmbajtjes së Programeve të angazhimit, konstatohet se :

- a. Programi përfshin objektin, qëllimin e auditimit, drejtimet kryesore të tij si dhe metodat e auditimit, për të identifikuar informacionin përkatës, të mjaftueshëm dhe të dobishëm gjatë angazhimit,
- b. Programi përcakton saktë objektin e auditimit, konformë përkufizimit të dhënë në ligjin 114/2015 të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”,
- c. Metodatat e përzgjedhura për vlerësimin e sistemeve, janë sipas përcaktimit në Kap.V të Manualit të AB ,

Ndër metodatat e përdorura janë :

- “Testimi hap pas hapi”,
- “ Testim i detajuar”,
- Metoda e krahasimit,
- Rishikimi analitik,
- Metoda e ekzaminimit.

3. Audituesit e brendshëm kanë përcaktuar fushëveprimin, shtrirjen dhe objektivat kryesore dhe specifike për çdo angazhim, duke përfutur informacionin mbi rezultatet e procesit vjetor të vlerësimit të riskut dhe konkluzionet e fazës përgatitore për çdo angazhim.
4. Fushëveprimi i auditimit ka qënë i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për të aritur objektivat e auditimit dhe realizimin e tij në mënyrë efektive. Në fushëveprimin e auditimit janë përfshirë sistemet/ fushat me risk të lartë, qasjet e audituesve mbi të dhënat në dokumentet, informacionet dhe çdo proces pune në njësinë/strukturën që auditon, që lidhen me objektivat e auditimit.
5. Audituesit e brendshëm kanë përcaktuar fushëveprimin, shtrirjen dhe objektivat konkrete të auditimit jo vetëm nga shfrytëzimi i informacionit, lidhur me risqet e identifikuara gjatë procesit të planifikimit vjetor të vlerësimit të riskut por dhe gjatë fazës përgatitore për çdo angazhim auditimi.
6. Në përfundim të fazës *“Puna në terren”*, audituesit në respektim të parimeve të komunikimit të rezultateve kanë zhvilluar takimin përmbyllës ku janë prezantuar gjetjet e evidentuara si dhe përmirësimet që grupi i auditimit gjykon për të adresuar. Dosjet administrojnë formatin e *“Takimit përmbyllës me subjektin e audituar”*.
7. Evidentohet që nuk është respektuar afati ditor i njoftimit të subjektit të audituar përpara takimit fillestar (*kur kërkesat metodologjike përcaktojnë që njësi publike duhet të njoftohet 10 ditë pune, përpara takimit fillestar*, Tabela nr 1), kjo për shkak të konfirmimit (me email) më përparatë të këtij takimi, nga drejtuesi i subjektit të audituar, referuar datës përcaktuese në shkresën *“Njoftim për fillimin e misionit”*.

SAB misionet e angazhimit, për periudhën objekt vlerësimi, i ka përllogaritur me numrin e punonjësve të miratuar sipas strukturës organizative të UBT(miratuar me Vendimin nr.32, datë 23.04.2019 dhe nr.88, datë 29.12.2020 të Bordit të Administrimit), me 3 punonjës.

Për periudhën e vlerësuar, në disa rastet (Tabela nr.3), konstatohet që grupi i punës, ka paraqitur kërkesën pranë K/Bordit të Administrimit për shtyrjen e afatit të auditimit në proces, duke përcaktuar afatin e shtyrjes së auditimit e parashtruar arsyet dhe shkaqet e mos realizimit të misionit në afatet e programuara, kërkesë kjo e cila është miratuar nga ky organ. Në vijueshmëri këto shtyrje nuk janë të shoqëruara me ndryshimet në programet e hartuara, si dhe struktura e audituar nuk është njoftuar për zgjatjen e afatit të auditimit.

Panvarësisht miratimit të shtyrjes së afateve të auditimit, konstatohet se janë tejkaluar afatet e përcjelljes së Projekt Raportit pranë strukturës së audituar. Në se grupet e auditimit, do të vlerësonin situatën apo shkaqet objektive të cilat janë bërë pengesë për përcjelljen e Projektit brenda afatit të miratuar, nëpërmjet miratimit të shtyrjes së afatit, këto të fundit mund të ishin respektuar.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Drejtuesi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit ushtrimor, të ndjekë zbatimin e planit vjetor të angazhimeve të miratuara nga Bordi i Administrimit dhe me qëllim ruajtjen e pavarësisë së auditimit dhe shmangien e vështirësive lidhur me nënshkrimin e çdo dokumenti nga ana e Bordit dhe komunikimit në kohë të përfundimeve të auditimit, Programi i Angazhimit të miratohet nga drejtuesi i Njesisë së AB.

✓ dosjet e auditimit administrojnë :

a. të gjitha letrat e punës të standartizuara të siguruara sipas përcaktimeve ligjore si: evidenca të marra apo të hartuara gjatë auditimit, kopje të dokumentave të ndryshme që janë përdorur gjatë auditimit, etj. Këto dokumente të përgatitura nga audituesit kanë qënë mbështetës për evidentimin dhe vlerësimin e rezultateve të punës së tyre, për gjetjet dhe konkluzionet e auditimit. Gjithashtu audituesit, në komunikimin e zhvilluar, pohojnë se tregojnë kujdes për respektimin e konfidencialitetit të të dhënave dhe dokumentacionit që aksesojnë për shkak të detyrës jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe etik.

b. letrat e punës, evidencat e përshtatshme dhe dokumentacionin justifikues të tërhequr sipas përcaktimeve ligjore, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të miratuar të auditimit. Evidencat e auditimit janë krijuar nëpërmjet informacioneve të marra gjatë punës, shqyrtimit të dokumentimit të sistemeve, rishikimit të dokumenteve thelbësorë mbi risqet, sistemet/fushat e përzgjedhura, dokument ky mbi të cilat audituesit kanë nxjerrë konkluzionet dhe mbështetur dhënien e opinionit të tyre sipas parashikimeve në MAB. (trajtuar gjerësisht në standardin 1300 dhe standardin 2000 të IIA).

✓ çdo grup auditimi, me përfundimin e procedurave të auditimit ka bërë sistemimin, klasifikimin dhe mbylljen e dokumenteve në dosjen e auditimit dhe arkivimin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore.

Në vijim sa është trajtuar tek Standardi 1300, grupi i vlerësimit, konstaton që çdo mision auditimi i është nënshtruar vlerësimit të brendshëm të cilësisë dhe ky proces dokumentohet të jetë kryer nga:

1. Çdo auditues, nëpërmjet plotësimit të formatit të miratuar, Aneksit nr. 1/1 "*Lista e kontrollit për monitorimin e brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm, nga çdo auditues*",
2. Përgjegjësi i grupit dhe Drejtuesi i SAB, nëpërmjet plotësimit të formatit të miratuar, Aneksit nr.1 "*Lista e kontrollit të vlerësimit të cilësisë gjatë monitorimit të brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm*".

Lista e kontrollit rezulton e plotësuar jo vetëm si check list, por dhe me komentet përkatëse .

Në disa raste, komentet përkatëse, paraqitur në disa rubrika tek Anekset (nr.1 dhe nr.1/1), rezultojnë jo korrekte (të kundërta), kjo sipas praktikave shkresore, konkretisht :

a. Në misionin mbi auditimin e sistemit të pagesave.

Pyetja e kontrollit nr.4 në Kreun III "Komunikimi i rezultateve (ISPPIA 2400) " tek Aneksi 1/1, është plotësuar me "Po" dhe me komentin :*P/Raporti është përgatitur brenda afateve të përcaktuara në MAB* (Faktikisht P/Raporti është dorëzuar me 15 ditë pune me vonese, mbi afatin e miratuar),

b. Në misionin mbi auditimin e sistemit të kontabilitetit dhe raportimit financiar.

Pyetja e kontrollit nr.4 në Kreun III "Komunikimi i rezultateve (ISPPIA 2400)" tek Aneksi 1/1, është plotësuar me "Po" dhe me komentin:*P/Raporti është përgatitur brenda afateve të përcaktuara në MAB, sipas shkresës nr.548, dt 24.03.2021* (Faktikisht P/Raporti është dorëzuar me 70 ditë pune me vonesë, mbi afatin e miratuar)

- ✓ në rubrikën “Përmbledhje ekzekutive” kanë paraqitur gjetjet dhe konkluzionet kryesore sipas sistemeve, vlerësimet e komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rekomandimet kryesore,
- ✓ janë përqëndruar në sistemet me të rëndësishme që ekspozojnë strukturën/subjektin ndaj rrezikut,
- ✓ për çdo sistem të vlerësuar kanë paraqitur gjetjet dhe rekomandimet përkatëse si dhe është reflektuar lidhja organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime (kryesisht për raportet e hartuara me strukturën e re),
- ✓ gjetjet në të gjitha raste i kanë mbështetur me dokumentacionin justifikues, pjesë e inventarit të dosjes,
- ✓ kanë trajtuar si çështje më vehte vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke analizuar dhe vlerësuar të gjithë komponentët e kontrollit të brendshëm në strukturat e audituara, në funksion kjo të rolit dhe misionit të auditimit të brendshëm *për ti dhënë siguri të arsyeshme titullarit të njësisë publike, në identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, vlerësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm;*
- ✓ zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme e kanë trajtuar si pikë të veçantë në programin e angazhimit,
- ✓ në mbyllje të raportit, kanë dhënë opinionin e përgjithshëm mbi : funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut si dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të riskut (I lartë, I mesëm dhe I ulët),
- ✓ në Projekt Raport nuk është paraqitur përfaqësuesi i strukturës/subjektit të audituar,
- ✓ Projekt Raportin përcjellë subjektit të audituar e ka shoqëruar me Formatin e sygjëruar të Plan Veprimit për zbatimin e rekomandimeve,
- ✓ Në shkresat përcjellëse të Raporteve, ka bërë me dije subjektin e audituar, mbi të drejtat dhe detyrimet ligjore ndaj NJAB (e drejta e paraqitjes së observacioneve, reagimi në lidhje me rekomandimet paraprake të paraqitura në Projekt raport, brenda 10 ditëve nga mbritja e Projektit dhe detyrimi i plotësimit dhe përcjelljes së planveprimit brenda periudhës 30 ditore nga marrja e Raportit).

Përfundimisht, grupi i vlerësimit i konsideron raportet e auditimit objektive, të besueshme, të pranueshme, të sakta, konstruktive, të qarta, që përfshijnë informacione mbi faktet dhe gjetjet, të bazuar mbi evidencat e mjaftueshme por që nuk janë evaduar brenda afateve kohore të përcaktuar në MAB, vonesa të cilat lidhen me kompleksitetin dhe format e organizimit të brendshëm të këtij Institucioni të Arsimit të Lartë Publik (IALP).

Dokumentohet që :

- ✓ Drejtuesi i SAB konformë detyrimit të përcaktuar në pikën 4.1.11 të Manualit të AB ka shoqëruar dërgimin e Projekt Raportit pranë strukturës së audituar, me modelin e sugjeruar të plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve (sipas Formatit standard 10) të paraqitura në projekt raport sipas nivelit të rëndësisë dhe afateve për zbatimin e tyre,
- ✓ Drejtuesi i SAB, konform detyrimit të përcaktuar në:
 - Pikën 4.1.12 të Manualit të AB,
 - Pikën IX “Raportimi dhe monitorimi” të Kartës së Auditimit të Brendshëm të UBT,

Rekomandimi 11: *Komisioni i shqyrtimit të bursave, gjatë trajtimit me bursë të studentëve duhet të evidentojë me saktësi... ..*

Nga dosjet e vlerësuara u konstatua se :

- ato administrojnë formatin e Plan Veprimit të miratuar nga drejtuesi i subjektit të audituar.
- të gjitha subjektet/strukturat e audituara kanë përcjellë, brenda afateve ligjore, pranë SAB, plan veprimin mbi zbatimin e rekomandimeve, ku të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i brendshëm janë pranuar nga menaxhimi i lartë. Nga ky fakt grupi i vlerësimit gjykon se propozimet janë konsideruar konstruktive dhe të zbatueshme për përmirësimin e veprimtarisë së tyre.
- referuar klasifikimit në planveprim të rekomandimeve, evidentohet se natyra e tyre është sipas gjetjeve dhe karakteristikave të njësive të audituara. Audituesit kanë adresuar gjetjet sipas rëndësisë, duke argumentuar që zbatimi i tyre do të ndihmojë menaxhimin në arritjen e objektivave, duke përmirësuar sistemet e kontrollit të brendshëm.

Subjekteve të audituara ju është dhënë mundësia për të shprehur opinionin/kundërshtitë mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit. Nga dosjet e përzgjedhura rezultoi se observacionet janë trajtuar në një Aneks shoqërues të Raportit Final të Auditimit, apo në vijim të trajtimit të gjetjes në raport.

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Për një komunikim në mënyrë të qartë të rezultateve dhe çështjeve të rëndësishme të identifikuara nga auditimi i brendshëm dhe vlerësimit të tyre nga ana e titullarit të subjektit të audituar, grupi i auditimit në Projekt Raport të shënojë përfaqësuesin e palës së audituar.

Rekomandim: Audituesit e brendshëm, gjatë hartimit të raportit, të mbajë parasysh parimet dhe kërkesat metodologjike, duke shmangur përdorimin e supozimeve dhe shprehjet e pasakta si : “duhet”, “në përgjithësi”, “duket”.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2400, thekson faktin se:

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:

 - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin.

• STANDARD ISPPIA 2500 - MONITORIMI I PROGRESIT

Ky standard përcakton që Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të vendosë dhe të mirëmbajë një proces rishikimi për të monitoruar shpërndarjen e rezultateve, të cilat i komunikohen menaxhimit.

audituar. Nga subjektet njihej detyrimi i përcaktuar në shkronjë "d", të nenit 12, të ligjit 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" lidhur me hartimin e zbatimit e planveprimit.

Gjithashtu sipas pohimeve të përfaqësuesit të subjektit të audituar, nga grupi i auditimit iu është theksuar fakti i plotësimit të planveprimit për zbatimin e rekomandimeve .

Sa trajtuar më sipër grupi i vlerësimit rekomandon:

Rekomandim: Sektori i Auditimit të Brendshëm të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, për të mundësuar ndreqjen e parregullsive dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe respektimin e afateve të raportimit për masat e marra.

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2500, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:

 - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin.

STANDARD ISPPIA 2600 – KOMUNIKIMI I PRANIMIT TË RISKUT

Sipas këtij standardi kur drejtuesi i njësisë së auditimit beson se menaxhimi i lartë ka pranuar një risk të mbetur, i cili mund të jetë i papranueshëm për njësinë, duhet ta diskutojë këtë çështje me menaxhimin e lartë. Nëse vendimi në lidhje me riskun e mbetur nuk zgjidhet, drejtuesi i DAB duhet të raportojë çështjen tek bordi për zgjidhje.

Gjatë periudhës së vlerësimit, të gjitha strukturat e audituara kanë pranuar rekomandimet e adresuara dhe kanë hartuar, miratuar e përcjellë prane SAB Planin e Veprimit, ku menaxhimi i lartë ka përmbyshur përgjegjësitë e tij ligjore dhe ka eliminuar riskun, veprime këto që nuk kanë sjellë ndërmarrjen e procesit të përshkallëzuar nga SAB .

Bazuar në dosjet e shqyrtuara, por edhe nga opinioni i siguruar nëpërmjet intervistave të realizuara nuk u evidentua asnjë rast i pranimi të riskut mbi nivelin e pranuar nga menaxhimi i subjektit të audituar. Megjithatë nga stafi auditues ishte i qartë misioni për përmbyshjen e detyrimit që rrjedh nga Standardi 2600 "Komunikimi i pranimi të riskut"

Opinion i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe plotësimin e kriterëve të Standardit 2600, thekson faktin se:

Sektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:

 - E gjelbër - në përputhje të plotë me standardin

10. Grupi i Auditimit, për çdo rast të argumentuar dhe të kërkuar për zgjatjen e afatit të angazhim auditimit, të miratojë tek Drejtuesi i SAB çdo rregullim të mundshëm të programit të angazhimit dhe një kopje të tij ta përcjellë zyrtarisht në subjektin e audituar.

11. Strukturat përkatëse dhe përgjegjëse (përgjegjësi i grupit të auditimit dhe Drejtuesi i SAB) të ngarkuara për kryerjen e procesit të sigurimit të cilësisë, të koordinojnë veprimet faktik, të argumentuara me praktikatat shkresore, gjatë komenteve të dhëna tek anekset “Lista e kontrollit të vlerësimit të cilësisë gjatë monitorimit të brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm”.

12. Për një komunikim në mënyrë të qartë të rezultateve dhe çështjeve të rëndësishme të identifikuara nga auditimi i brendshëm dhe vlerësimit të tyre nga ana e titullarit të subjektit të audituar, grupi i auditimit në Projekt Raport të shënojë përfaqësuesin e palës së audituar.

13. Audituesit e brendshëm, gjatë hartimit të raportit, të mbajë parasysh parimet dhe kërkesat metodologjike, duke shmangur përdorimin e supozimeve dhe shprehjet e pasakta si : “duhet”, “në përgjithësi”, “duket”.

14. Sektori i Auditimit të Brendshëm të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, për të mundësuar ndreqjen e parregullsive dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe respektimin e afateve të raportimit për masat e marra.

VI .OPINION I PËRGJITHSHËM

Opinioni i grupit të vlerësimit për përputhshmërinë e veprimtarisë të Sektorit të Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë me:

- përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe;
- parimet e parashikuara në grupin e standardeve të shqyrtuara paraqitet si më poshtë:

Vlerësimi për Standardet Kryesore

Standardi 1100 “ <i>Pavarësia dhe objektiviteti</i> ”	 E gjelbër
Standardi 1200 “ <i>Aftësia dhe kujdesi i duhur profesional</i> ”	 E gjelbër
Standardi 2000 “ <i>Menaxhimi i veprimtarisë së auditimit brendshëm</i> ”	 E gjelbër
Standardi 2200 “ <i>Planifikimi i angazhimit</i> ”	 E gjelbër
Standardi 2300 “ <i>Kryerja e Angazhimit</i> ”	 E gjelbër

Vlerësimi për Standardet Dytësore

Standardi 1000 “ <i>Qëllimi, Autoriteti dhe përgjegjësia</i> ”	 E verdhë
Standard 1300 “ <i>Sigurimi i cilësisë dhe programi i përmirësimit</i> ”	 E gjelbër
Standard 2100 “ <i>Natyra e Punës</i> ”	 E verdhë
Standardi 2400 “ <i>Komunikimi i rezultateve</i> ”	 E gjelbër

Standard 2500 <i>“Monitorimi i progresit”</i>	 E gjelbër
Standard 2600 <i>“Komunikimi i pranimi të riskut”</i>	 E gjelbër

Spektori i Auditimit të Brendshëm në Universitetin Bujqësor Tiranë funksionon:


-  E gjelbër - në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm, por që në disa fusha ku janë identifikuar mangësitë, kërkohen përmirësime, të shprehura nëpërmjet rekomandimeve të adresuara.

Raporti Përfundimtar i vlerësimit hartohet në 3(tre) kopje, dy prej të cilave dërgohen në Universitetin Bujqësor Tiranë

Grupi i vlerësimit

Sokol Bundo

Anila Lako



ANEKS 1: METODOLOGJIA

1. Metoda e përdorur

Raporti Përfundimtar për vlerësimin e jashtëm të cilësisë është hartuar duke u bazuar në shqyrtimin e grup standardeve (atributive dhe të performancës) të “Metodologjisë së Vlerësimit të Jashtëm të Cilësisë për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, e miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr. 22, datë 06.03.2017.

Grupi i vlerësimit e realizoi këtë angazhim nëpërmjet - *Metodës së përdorimit të pyetësorëve dhe konfirmimit*, të përcaktuar në Kapitullin V të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Metoda e përzgjedhur u vlerësua nga grupi si e përshtatshme dhe efektive për këtë vlerësim sepse informacioni i siguruar është i drejtpërdrejtë dhe i jep mundësi grupit të krijojë siguri në një nivel të pranueshëm mbi funksionimin e kësaj njësie auditimi në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranuar.

2. Vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë audituese me përcaktimet në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe grup standardet e shqyrtuara.

Përputhshmëria e veprimtarisë së njësisë së auditimit të brendshëm me standardet e shqyrtuara sipas metodologjisë së përdorur paraqitet nga katër rezultate të mundshme, të ilustruar me ngjyra:



e gjelbër, përputhje e plotë me standartin;



të verdhë, përputhje e pjesshme me standartin, por përmirësimi është i nevojshëm në fusha të caktuara;



portokalli, përputhje me standartin por në disa fusha kërkohen përmirësime kritike (të domosdoshme);



e kuqe, mospërputhje e plotë me standartin.



PLAN VEPRIMI MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ADRESUARA

NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

UNIVERSITETI BUJQËSOR, TIRANË

Numri Rekom	Rekomandimet	Niveli i riskut	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhimit të subjektit audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1.	Spektori i Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për përditësimin e Kartës së Auditimit të Brendshëm, pas ndryshimeve të Manualit të AB (miratuar me urdhërin nr.4, datë 10.01.2020 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë), miratimin e saj tek Bordin i Administrimit dhe përcjelljen pranë DH/AB në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë	I mesëm	Faqe 13	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë	
2.	Spektori i Auditimit të Brendshëm të propozojë plotësimet e nevojshme në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të tij, lidhur me komunikimin dhe të drejtën e raportimit, në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek Bordin i Administrimit.	I mesëm	Faqe 13	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë	

3.	Bordi i Administrimit të reflektore dhe të parashikojë në Rregulloren e brendshme të funksionimit të tij, kompetencat dhe funksionet ndaj Njësise së auditimit të brendshëm.	I mesëm	Faqe 13	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë	
4.	Administratori i UBT, për t'i siguruar një rol dhe një funksion sa me efektiv Grupit të Menaxhimit Strategjik, në përbërje të tij të përfshijë edhe Drejtuesin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm, kjo në kuadër të diskutimit të çështjeve që lidhen me sistemin e kontrollit të brendshëm dhe komponentët e tij, menaxhimit efektiv të risqeve dhe adresimin e mangësive të konstatuara nga auditimi i brendshëm.	I ulët	Faqe 18	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë	
5.	Audituesit e brendshëm në raportet e auditimit, të pasqyrojnë marrjen në shqyrtim të regjistrit të riskut pranë njësise/strukturës së audituar, si dhe dhënien e vlerësimit e rekomandimit përkatëse, të orientuar për hartimin e regjistrit të riskut apo rishikimit e përditësimit të tij, kur risku është rritur, apo kur aktivitetet e kontrollit të ndërmara nuk janë të mjaftueshme për minimizimin e tij.	I mesëm	Faqe 34	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë dhe në vazhdimësi	

6.	Grupi i auditimit të dokumentojë procesin e auditimit, gjatë fazës paraprake të angazhimit, lidhur me hartimin e listës së kontrolleve dhe pyetësorëve përkatës të sistemit të kontrollit të brendshëm, të cilët ndihmojnë audituesit, për marrjen e informacionit të nevojshëm, lidhur me gjëndjen dhe dobësitë e kontrolleve të ngritura.	I mesëm	Faqe 34	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë dhe në vazhdimësi	
7.	Drejtuesi i Sektorit të Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit ushtrimor, të ndjekë zbatimin e planit vjetor të angazhimeve të miratuara nga Bordi i Administrimit dhe me qëllim ruajtjen e pavarësisë së auditimit e shmangien e vështirësive lidhur me nënshkrimin e çdo dokumenti nga ana e Bordit dhe komunikimit në kohë të përfundimeve të auditimit, Programi i Angazhimit të miratohet nga drejtuesi i Njësisë së AB.	I ulët	Faqe 37	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë dhe në vazhdimësi	
8.	Organet kolegjiale drejtuese të Universitetit BT (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit), të bëjnë ndryshimet e duhura në Statutin e UBT, lidhur vetëm me kompetencën e Bordit të Administrimit, për miratimin e programeve të angazhimit, sepse ky organ është përfuturi dhe përdoruesi i rezultateve të punës së auditimit.	I mesëm	Faqe 38	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë	

x

9.	Grupi i auditimit të respektojë kërkesat metodologjike lidhur me afatin e përcjelljes së Projekt raportit pas përfundimit të angazhimit e Raportit përfundimtar tek subjekti i audituar	I ulët	Faqe 38	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Menjëherë dhe në vazhdimësi	
10.	Grupi i Auditimit, për çdo rast të argumentuar dhe të kërkuar për zgjatjen e afatit të angazhim auditimit, të miratojë tek Drejtuesi i SAB çdo rregullim të mundshëm të programit të angazhimit dhe një kopje të tij ta përcjellë zyrtarisht në subjektin e audituar.	I ulët	Faqe 38	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin..	Për çdo rast e në vazhdimësi	
11.	Strukturat përkatëse dhe përgjegjëse (përgjegjësi i grupit të auditimit dhe Drejtuesi i SAB) të ngarkuara për kryerjen e procesit të sigurimit të cilësisë, të koordinojnë veprimet faktik, të argumentuara me praktikë shkresore, gjatë komenteve të dhëna tek anekset “Lista e kontrollit të vlerësimit të cilësisë gjatë monitorimit të brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm”.	I ulët	Faqe 40	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Në vazhdimësi	
12.	Për një komunikim në mënyrë të qartë të rezultateve dhe çështjeve të rëndësishme të identifikuara nga auditimi i brendshëm dhe vlerësimit të tyre nga ana e titullarit të subjektit të audituar, grupi i auditimit në Projekt Raport të shënojë përfaqësuesin e palës së audituar.	I ulët	Faqe 43	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Në vazhdimësi	

13.	Audituesit e brendshëm, gjatë hartimit të raportit, të mbajë parasysh parimet dhe kërkesat metodologjike, duke shmangur përdorimin e supozimeve dhe shprehjet e pasakta si : “duhet”, “në përgjithësi”, “duket”.	I ulët	Faqe 43	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Në vazhdimësi	
14.	Spektori i Auditimit të Brendshëm të dokumentojë procesin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe komunikimin me subjektin e audituar, lidhur me marrjen e informacionit mbi progresin që është bërë për zbatimin e rekomandimeve, për të mundësuar ndreqjen e parregullsive dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe respektimin e afateve të raportimit për masat e marra.	I ulët	Faqe 45	Menaxhimi dhe NJAB ka pranuar rekomandimin.	Në vazhdimësi	

GRUPI I VLERËSIMIT

SOKOL BUNDO



ANILA LAKO

